



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
DREJTORIA E PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Elbasan, më \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / 2020

**LËNDA: Dërgim njoftimi i fituesit për botim në Buletinin e Njoftimeve Publike.**

AGJENCISE SË PROKURIMIT PUBLIK

TIRANË

**NJOFTIMI I FITUESIT**

Nga: **Bashkia Elbasan** adresa: rruga “Qemal Stafa”, Elbasan.

Për: **“Zeqiri” sh.p.k me adresë:** lagjja "Bishanak", rruga "Skëndërbeu", Fier.

Procedura e prokurimit: **“Kërkesë për Propozim”.**

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-63549-07-01-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Blerje kazanë mbetjesh urbane”**, me fond limit **4,499,955** (katërmilion e katërqind e nëntëdhjetë e nëntëmijë e nëntëqind e pesëdhjetë e pesë) **lekë pa t.v.sh.**, vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Elbasan për vitin 2020, me afat për dorëzimin e mallit **20 ditë** nga data e lidhjes së kontratës.

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [Data ] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

**1. “Bolt” sh.p.k. me Nipt: K 91517011 V**

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **4,455,000** (katërmilion e katërqind e pesëdhjetë e pesëmijë) **lekë** (pa tvsh) dhe me vlerë kontrate prej **5,346,000** (pesëmilion e treqind e dyzet e gjashtëmijë) **lekë** (me tvsh).

**2. “Zeqiri” sh.p.k me Nipt: J 67902827 A**

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **4,421,250** (katërmilion e katërqind e njëzet e njëmijë e dyqind e pesëdhjetë) **lekë** (pa tvsh) dhe me vlerë kontrate prej **5,305,500** (pesëmilion e treqind e pesëmijë e pesëqind) **lekë** (me tvsh).

### **Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:**

1. Ofertuesi **“Bolt” sh.p.k. me Nipt: K 91517011 V**

### **Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

1. Ofertuesi **“Bolt” sh.p.k** skualifikohet për arsye se: Ky operator ekonomik kishte mangësi në dokumentacionin e paraqitur e konkretisht:

1. Në pikën 2.3.1 të Kapacitetit Teknik të DST kërkohet: **Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të ngjashme** për një vlerë jo më të vogël se **40%** e vleres se fondit limit, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit. Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtëm:

a) **Kontrata për furnizime të ngjashme të shoqëruara me “Vërtetimin nga institucioni përkatës për kontratën e realizuar”, nëse furnizimi është kryer me një ent publik;**

ose

**Në rast se përvoja e mëparshme është realizuar me sektorin privat si dëshmi do të pranohen vetem fatura tatimore shitje** ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasitë e mallrave të furnizuara dhe emri e nënshkrimi i personit blerës.

Operatori ekonomik, në përmbushje të këtij kriteri, ka dorëzuar 3 kontrata furnizimi nga të cilat 2 (dy) janë të realizuara më herët se 3 vitet e fundit nga data e zhvillimit të tenderit, ndërsa kontrata e tretë ka një vlerë më të vogël se **40%** e vleres se fondit limit të prokuruar, duke mos përmbushur kështu kriteri e mësipërm.

2. Në pikën 2.3.4 të Kapacitetit Teknik të DST kërkohet: Në rast se operatori ekonomik ofertues nuk është prodhues, ai duhet të paraqesë Autorizim nga prodhuesi ose distributori për mallin objekt prokurimi si dhe :

-Katalog të konteniervë të ofruar

-Deklaratë konformiteti me standartet e komunitetit Evropian dhe markimin me CE

-Çertifikatë Konformiteti EN1461:2009, për konformitetin e galvanizmit të konteniervë me normën Evropiane.

-Çertifikatë Konformiteti EN 840, për konformitetin e kazanëve me normën Evropiane.

Operatori Ekonomik në përmbushje të këtij kriteri, ka paraqitur vetëm një katalog, dhe asnjë nga dokumentat e tjerë të kërkuar si mësipër.

Në nenin 46, pika 1/b, të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i

ndryshuar parashikohet se : “[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës[...]

Në nenin 53 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.”

Sa mësipër, komisioni i vlerësimit të ofertave vendosi ta refuzojë ofertën.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë subjektin: **“Zeqiri” sh.p.k. me adresë:** lagjja "Bishanak", rruga "Skëndërbeu", Fier, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **4,421,250** (katërmilion e katërqind e njëzet e një mijë e dyqind e pesëdhjetë) **lekë pa tvsh**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Bashkisë Elbasan (Drejtoria e Prokurimeve)**, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **5 (pese) ditëve** nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktor do të anulojë procedurën, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

**Njoftimi i klasifikimit është bërë në datë: 29.07.2020**

**Ankesa nuk ka patur.**

**TITULLARI I AUTORITETIT**

**KONTRAKTOR**

**PERSONI I AUTORIZUAR PREJ TIJ  
ZV.KRYETARI**

**Irland Sina**